



Pranuar / Dorezuar Punë/Produkt Received/Delivered	09.11.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr. Prot Pr. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEKRSHTOR	6660/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.505/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardit Haxhnikaj Demi-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Akgjykimit Anr.687/22 të datës 28.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, te pranuar me date 04.10.2022 ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.505/2021 të datës 07.06.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë: kundër organit të punësimi/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.505/2021 e datës 07.06.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunë të Prishtinës, sipas Akte emrimit nr.112-118 të datës 26.12.2017 në pozitën "Zyrtare Ligjore 2", në Sektorin Ligjor, me datë 23.04.2021 ka parashtruar kërkesën me numër 14-117/01-73554/21 tek Njësia e Burimeve Njerëzore, për zbatim të Vendimit me numër 01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për pagesën e shujtës ditore nga data 01.02.2017.

Ankuesja kundër heshtjes administrative, me datë 07.06.2021 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 2911/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për zbatimin e Vendimit me numër 01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për pagesën e shujtës ditore nga data 01.02.2017, e parapara në vlerë 2.5 euro.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.06.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunë të Prishtinës, mirepo nuk ka marrë përgjigje.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 22.07.2021 e ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtën që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 26.09.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.687/2022 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 22.07.2021 të parashtruar nga ankuesja.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunë të Prishtinës, duke i njoftuar se nga data 09.06.2021 Këshilli ende nuk ka marr përgjigje në kërkesë e datës 09.06.2021. Këshilli më datë 02.11.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës me dokumentete e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimin Anr.687/22 të datës 28.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me Nr. Prot:2911/2021 të datës 07.06.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit me numër 01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Kërkesë e datës 23.04.2021 për zbatim e Vendimit me numër 01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt emërim 01nr.112-1118 e datë 19.01.2017; Akt emërim 01nr.112-1118 e datë 26.12.2017; Kërkesë për mes E-mailit zyrtar të KPMSHCK-së i datës 31.10.2022, drejtuar Njesisë së Personelit në Komunë të Prishtinës, pas pranimit të Aktgjykimin Anr.687/22 të datës 28.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; E-mail i datës 02.11.2022 përgjigje në Ankesë nga Komuna e Prishtinës; Kërkesë e datës 2.11.2022 për prova shtes drejtuar Njesisë së Personelit në Komunë të Prishtinës; Përgjigja e Komunes së Prishtinës përmes e emailit e datës 02.11.2022 me dokumentete e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar me shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja është e punësuar sipas Akte emërimin nr.112-118 të datës 26.12.2017 në pozitën "Zyrtare Ligjore 2", në Sektorin Ligjor në Komunën e Prishtinës. Ankuesja me datë 23.04.2021 ka parashtruar kërkesë me numër 14-117/01-73554/21 tek Njësia e Burimeve Njerëzore, për zbatim të Vendimit me numër 01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, për lejimin e mjeteve financiare për shujten ditore gjegjesisht kompensimin e shujtes ditore në vlerë 2.5 euro nga data 01.02.2017, mjerpo e njëjet nuk ka pranuar përgjigje nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës në kërkesën e datës 23.04.2021 me numër 14-117/01-73554/2.

Ankuesja kundër heshtjes administrative nga organi i punësimit me datë 07.06.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore për zbatimin e Vendimit me numër 01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës për lejimin e mjeteve financiare për shujten ditore gjegjesisht kompensimin retroaktiv të shujtes ditore në vlerë 2.5 euro nga data 01.02.2017 respektivisht nga miemti kur ankuesja e ka themeluar mardhenien e punësimit në Komunën e Prishtinës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankueses dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Kuvendi Komunal i Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datë 20.05.2010 ka miratuar Vendimin për lejimin e mjeteve buxhetore për pagesat të shujtes ditore në vlerë prej 2.5 euro për shërbysit civil të administratës së komunës, duke filluar nga data 01.04.2010, duke përcaktuar në nenin 4 se vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij në mbledhjen e Kuvendit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ju referua nenit 144 paragraf 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: "3. Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin", rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe lidhur me datën e miratimit të Vendimit me numër 01-0400-970 të datës 21.05.2010 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, kanë kaluar mbi pesë vite si dhe duke marrë parasysh faktin në shkresat e lëndës Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi se është ndërmarrë ndonjë veprim për ekzekutimin e tij, andaj mbi këto arsye ligjore Kolegji konstaton se Vendimi në fjalë mbi bazën e të cilit ankuesja ka parashtuar ankesë është i pa ekzekutueshëm, përkatësisht nisur nga ky konstatim rezulton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.505/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës ;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

